



Në pajtim me autorizimin që i është dhënë në nenin 35, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më 30 shtator 2015, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MBËSHTETJE EMERGJENTE PËR LIKUIDITET

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen nga bankat të cilat kërkojnë mbështetje emergjente për likuiditet, llojet e pranueshme të kolateralit, kushtet dhe procesin e vlerësimit të një kërkesë të tillë me qëllim të zbatimit të nenit 14 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) i cili autorizon BQK-në, që në rrethana të jashtëzakonshme dhe sipas gjykimit të saj të veprojë si kreditor i instancës së fundit për një bankë të licencuar, si dhe në pajtim me nenin 12, paragrafi 1 të Ligjit mbi BQK-në që autorizon BQK-në të ndryshojë përkohësisht rezervat minimale të bankave të caktuara.

Neni 2 Përkufizimet

- 1. Bankë** – një subjekt i licencuar nga BQK-ja siç definohet në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
- 2. BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- 3. Mbështetje Emergjente për Likuiditet (MEL)** – BQK-ja ofron mbështetje për likuiditet të një banke me anë të një reduktimi të përkohshëm të rezervave minimale, ose me një kredi ndaj një banke të licencuar nga BQK-ja, ose një kombinim i të dyjave kur banka është solvente, por që kërkon MEL për të plotësuar nevojat e saj për likuiditet afatshkurtër.

- 4. Fondet në dispozicion për MEL** – Shuma totale e rezervave e përcaktuar sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.
- 5. Norma e interesit për MEL** – Norma e interesit që ngarkohet për MEL e përcaktuar sipas nenit 4, paragrafi 1, i kësaj rregulloreje.
- 6. Banka solvente** – një bankë që sipas vlerësimit të Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare të BQK-së në bazë të informatave aktuale në dispozicion, asetet tejkalojnë detyrimet e saj duke përfshirë lëvizjet në periudhat e ardhshme (anglisht: *forward looking basis*).
- 7. Bankë e shëndoshë** – një bankë që është konsideruar e shëndoshë sipas mendimit të BQK-së bazuar në informatat në dispozicion.
- 8. Ulje e përkohshme në rezervat minimale të një banke** – një ulje e përkohshme në rezervat minimale të bankës të përcaktuar nga BQK-ja sipas nenit 12 të Ligjit të BQK-së.
- 9. Formulari MEL 1** – Aplikacioni për mbështetje emergjente për likuiditet.
- 10. Formulari MEL 2** – Procedurë e brendshme për MEL dhe Formulari i vlerësimit për MEL.

Neni 3

Kërkesat për mbështetje emergjente për likuiditet

1. Një kërkesë për mbështetje emergjente për likuiditet duhet të bëhet duke u bazuar në Formularin MEL 1 dhe të shoqërohet me dokumentet si në vijim:
 - 1.1. Një kopje e vendimit të bordit të drejtorëve të bankës aplikuese të nënshkruar nga kryesuesi dhe kryeshefi ekzekutiv i bankës që vërteton se bordi ka konstatuar se banka është solvente;
 - 1.2. Një kopje të pasqyrave të fundit financiare të bankës;
 - 1.3. Një deklaratë që shpjegon arsyet mbi paaftësinë e bankës për t'i përmbushur nevojat e saj për likuiditet dhe që specifikon se të gjitha burimet e likuiditetit janë hulumtuar dhe janë shterur plotësisht;
 - 1.4. Një kopje e plotësuar, nënshkruar e Formularit për MEL 1 i cili përcakton shumën dhe maturitetin e ndihmës së kërkuar për likuiditet, si dhe një përshkrim të plotë të kolateralit që do të ofrohet për të mbështetur kredinë;
 - 1.5. Banka duhet të dorëzojë në BQK për aprovim programin përmirësues lidhur me rikthimin e bankës në gjendje likuide;
 - 1.6. BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë për shqyrtimin e aplikacionit nga banka aplikuese.

Neni 4

Kriteret për MEL

1. Aprovimi i MEL-it duhet të bëhet sipas kriterëve në vazhdim:
 - 1.1. Norma e interesit duhet të jetë të paktën tre pikë përqindjeje mbi normën mesatare të interesit në depozita të bankave në Kosovë, siç është llogaritur dhe publikuar nga BQK-ja (bazuar në të dhënat e fundit);
 - 1.2. Norma e interesit që do të aplikohet në çdo rast të MEL-it do të vendoset nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së si pjesë e rekomandimit të tij lidhur me aplikimin për MEL;
 - 1.3. Reduktimi maksimal i rezervës minimale të bankës që mund të aprovohet është katër pikë përqindjeje;
 - 1.4. Shuma e aprovuar në kuadër të MEL do të jetë plotësisht e kolateralizuar konform kushteve të kolateralit siç janë përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
 - 1.5. BQK-ja rezervon të drejtën për të imponuar kushte shtesë për miratim, në kohën e kërkesës për MEL.

Neni 5

Llojet dhe kushtet e kolateralit

1. BQK-ja mund të ofrojë MEL-in vetëm për ato raste që janë të mbuluara me kolateral siç specifikohet në vazhdim:
 - 1.1. Letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës me shkallë zhvlerësimi bazuar në vlerën e tregut në datën kur është kërkuar MEL-i;
 - 1.2. Letra me vlerë të tregtueshme të emtuara nga një qeveri ose institucion financiar ndërkombëtar, në valutën euro dhe me një klasifikim kreditor nga të paktën dy agjenci ndërkombëtare të rangimit me shkallë ranguese minimale BBB ose shkallë tjetër ekuivalente, si dhe me shkallë zhvlerësimi bazuar në vlerën e tregut në datën kur është kërkuar MEL-i;
 - 1.3. Ari me shkallë zhvlerësimi bazuar në vlerën e tregut në datën kur është kërkuar MEL-i;
 - 1.4. Për qëllime të MEL-it, përveç kolateralit të specifikuar si më lartë, Bordi Ekzekutiv i BQK-së mund të pranojë edhe kolateral tjetër të pranueshëm, siç specifikohet në një akt tjetër të brendshëm të BQK-së, të nxjerrë nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së.
2. Maturiteti i kolateralit që kolateralizon MEL-in duhet të jetë më i gjatë se maturiteti MEL-it.
3. Kolaterali duhet të depozitohet në BQK apo me vendimin e saj në një bankë tjetër të pranueshme për BQK-në.

4. Nëse BQK-ja vendos të japë mbështetje për likuiditet përmes reduktimit të përkohshëm në rezervat minimale të bankës, bankës nuk i kërkohet të vendosë kolateralin në BQK.

Neni 6

Ripërtëritja për MEL

1. Të paktën 3 ditë të punës para datës së skadimit të MEL-it të dhënë për një bankë, banka pranuese e MEL-it deklaron me shkrim te Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare të BQK-së që nuk është në gjendje të shlyej MEL-in, qoftë në mënyrë të plotë ose pjesëshmë. Bordi Ekzekutiv i BQK-së, në raste të tilla mund që me aprovim të Bordit të BQK-së të ripërtërijë MEL-in me një normë interesi të barabartë ose më të lartë se norma e interesit e zbatueshme për MEL fillestar.
2. Bordi Ekzekutiv i BQK-së mund të ndryshojë kushtet dhe formën në të cilën jepet MEL-i në rast të ripërtëritjes gjithmonë duke pasur parasysh, që kriteret vazhdojnë të jenë në pajtueshmëri me këtë rregullore.
3. Sipas procedurave të njëjta siç definohet në paragrafin 1 të këtij neni, banka mund të aplikojë për ripërtëritje të MEL-it;
4. Para aprovimit të çdo ripërtëritje, Bordi Ekzekutiv i BQK-së duhet të pranojë dëshmi të pranueshme lidhur me zbatimin e programit përmirësues të saj.
5. Me rastin e miratimit të një kërkesë nga një bankë për ripërtëritje të MEL-it, kushtet për miratimin e saj përfshijnë si në vijim:
 - 5.1. Nuk ka pagesa të dividendës përderisa MEL të mos jetë shlyer;
 - 5.2. Nuk ka pagesa të bonuseve apo pagesa të tjera të veçanta të anëtarëve të Bordit dhe stafit të lartë të bankës;
6. Kur Bordi i BQK-së vendos se MEL-i nuk do të ripërtërihet, bankës i kërkohet të shlyej MEL-in në datën e caktuar. Në qoftë se banka nuk është në gjendje të shlyej MEL-in në mënyrë të plotë, BQK-ja do të zbatojë (shes) kolateralin e ofruar për MEL dhe do të marrë të gjitha veprimet bazuar në Ligjin për Banka, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare. BQK-ja do të vazhdojë të ngarkojë interesin për MEL nga të hyrat nga kolaterali derisa kredia të mos jetë shlyer në tërësi.

Neni 7

Fondet në dispozicion për MEL

Për qëllim të MEL-it, fondet në dispozicion përfshijnë shumën totale të rezervave të BQK-së dhe Fondin Special të Rezervave të themeluar nga Thesari për këtë qëllim, siç specifikohet në nenin 14, pika 4 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Renditja e përdorimit të fondeve në dispozicion siç specifikohen më lartë, do të përcaktohet me një akt tjetër të brendshëm të BQK-së, të nxjerrë nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së.

Neni 8
Shtojca

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë Forma MEL 1 dhe Forma MEL 2.

Neni 9
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Mbështetje Emergjente për Likuiditet të aprovuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 29 dhjetor 2011.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 5 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Bedri Peci _____



Forma MEL 1: Aplikacioni për mbështetje emergjente me likuiditet

1. Emri dhe adresa e bankës kërkuese: _____
 2. Emri dhe titulli i përfaqësuesit të autorizuar: _____

 3. Nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar: _____
(personi që nënshkruan kërkesën duhet të jetë një nga përfaqësuesit e autorizuar nga banka që është në listë në BQK).
-

4. Lloji i kërkuar i mbështetjes për likuiditet:
 - i) Mbështetje fillestare për likuiditet: _____
 - ii) Ripërtëritja e parë e MEL-it ekzistues: _____
 - iii) Ripërtëritja e dytë e MEL-it ekzistues: _____
 - iv) Periudha e mbështetjes së kërkuar: _____
 - v) Shuma e kërkuar: _____ (milion EUR)
 - vi) Kolaterali i ofruar për një kredi MEL (duhet të jetë në pajtim me nenin 5 të Rregullores për Mbështetjen Emergjente me Likuiditet)

Përshkrimi Vlera kontabël Vlera e tregut Maturiteti Pengu (Y/N)

vii) Dokumentet që duhet të bashkëngjiten:

1. Për letrat me vlerë të brendshme të ofruara si kolateral, një dëshmi zyrtare mbi bartësin (blerësin) e lëshuar nga Thesari.
2. Për letrat me vlerë të huaja të ofruara si kolateral, një dëshmi zyrtare mbi bartësin (blerësin) sipas legjislacionit përkatës të vendit të emetimit.
3. Një kopje e vendimit të bordit të drejtorëve të bankës aplikuese të nënshkruar nga kryesuesi dhe kryeshefi ekzekutiv i bankës që vërteton se bordi ka konkluduar se banka është solvente.
4. Një kopje e pasqyrave të fundit financiare të bankës sipas nenit 3, pika 1.2 të Rregullores për Mbështetje Emergjente me Likuiditet.
5. Një deklaratë e nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv mbi arsyet se pse banka nuk është në gjendje të përmbushë nevojat e saj për likuiditet nga burime të tregut.
6. Nëse banka aplikuese është banke e jashtme, një deklaratë formale nga banka amë se pse banka amë nuk është në gjendje t'i ofrojë bankës aplikuese nevojat për likuiditet.
7. Banka duhet të ofrojë një program të detajuar përmirësues për rivendosjen e pozicionit të saj për likuiditet.